



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-07/IA001

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 4 nëntor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për caktimin e panelit të Gjykatës së Apelit

Gjykatësve të panelit të Gjykatës së Apelit:

Gjykatës Mishel Pikar

Gjykatës Emilio Gati

Gjykatës Kai Ambos

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hysni Gucatit:

Xhonathan Elistan Ris

Mbrojtësit të Nasim Haradinajt:

Bastian Martens

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të neneve 33(1)(c), 41(10) dhe 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 të Dhomave të Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”),¹ rregullave 58, 169 dhe 170 të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”) dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtar (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi cakton një panel të Gjykatës së Apelit për të vendosur lidhur me apelin e ndërmjetëm të z. Hysni Gucatit ndaj dy vendimeve nga gjykatësi i vetëm, në lidhje me arrestimin dhe paraburgimin e tij (“Apeli”).²

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 27 tetor 2020, Gjykatësi i Vetëm lëshoi dy vendime.³ Në vendimin e parë, Gjykatësi i Vetëm, ndër të tjera, refuzoi mocionin e z. Gucatit: (i) ku ai kërkoi caktimin e një gjykatësi tjetër për të vendosur lidhur me kundërshtimet rreth paraburgimit të tij; (ii) ku ai kërkoi një urdhër për t’iu dhënë i gjithë materiali dhe provat apo faktet relevante në posedim të Zyrës së Prokurorit të Specializuar; dhe (iii) kundërshtimin e ligjshmërisë së fletarrestimit të tij (“Vendim i Kontestuar i Parë”).⁴ Në vendimin e dytë, Gjykatësi i Vetëm, refuzoi kërkesën për lirim me kusht të z. Gucatit. (“Vendim i Kontestuar i Dytë”).⁵

2. Më 3 nëntor 2020, z. Gucati apeloj: (i) vendimin e kontestuar të parë, lidhur me me refuzimin e kundërshtimeve të tij rreth ligjshmërisë së fletarrestimit; dhe (ii) vendimin e kontestuar të dytë.⁶

¹ Kryetarja rikujton se në bazë të neneve 33(1)(a), (c) dhe 45 të Ligjit, një caktim i panelit të Gjykatës së Apelit, ndodh pasi një i akuzuar ka parashtruar një apel të ndërmjetëm në lidhje me një vendim të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake. Në rastin aktual, apeli i ndërmjetëm është parashtruar

II. CAKTIMI

3. Duke marrë parasysh kriteret e përcaktuara në rregullën 4(2) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, përfshirë edhe kompetencën dhe përvojën përkatëse si dhe disponueshmërinë në këtë moment,

KRYETARJA CAKTON :**Gjykatës Mishel Pikar****Gjykatës Emilio Gati****Gjykatës Kai Ambos**

në panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur lidhur me apelin.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare e Dhomave të Specializuara

nga z. Gucati, i cili aktualisht është i dyshuar. Kryetarja është e mendimit se, duke qenë se apeli i ndërmjetëm ka të bëjë me thelbin e të drejtave themelore të njeriut, përkatësisht të drejtën e lirisë, këta faktorë madhorë kanë përparësi, dhe si rrjedhojë z. Gucati nuk duhet të pengohet të dëgjohet në apel. *Shih Medvedyev and others v. France/Medvedjev* dhe të tjerët kundër Francës, Judgment/Aktgjykim, 29 mars 2010, para. 76 (“Gjykata thekson se neni 5 i Konventës mbron të drejtën e lirisë dhe sigurisë. Kjo e drejtë ka rëndësinë më të madhe “në një shoqëri demokratike” brenda kuptimit të Konventës”); *Winterwerp v. the Netherlands/Winterwerp* kundër Holandës, Judgment/Aktgjykim, 24 tetor 1974, para. 37, Seria A nr. 33. *De Wilde, Ooms and Versyp v. Belgium/De Vilde, Oms dhe Versip* kundër Belgjikës, Judgment/Aktgjykim, 18 qershor 1971, para. 65, Seria A nr. 12. Ky parim pasqyrohet plotësisht në Rregulloren e Procedurës dhe Provave përkatëse.

² IA001/F00001, Njoftim për apel të ndërmjetëm në emër të Hysni Gucatit (“Apeluesi”), 3 nëntor 2020.

³ F00057, Vendim për kundërshtimet e Mbrojtjes, 27 tetor 2020; F00059, Kërkesë për dorëzani, 27 tetor 2020.

⁴ Vendim i Kontestuar i Parë, para. 48.

⁵ Vendim i Kontestuar i Dytë, para. 25.

⁶ *Shih në përgjithësi* Apel.

E mërkurë, 4 nëntor 2020
Në Hagë,
Holandë